ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: **AGJENCIONI VETERINARISË DHE USHQIMIT**
Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **Nr. i prokurimit: 40800-24-9255-2-1-1**

Sa i përket tenderit për: **"Zhvillimi dhe mirëmbajtja e Sistemit të kontrollimit të ushqimit dhe menaxhimit të gjurmueshmërisë (FCMS)"**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

NOVUS SH.P.K., NUI:810818586
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Tirana, 31, Kati 6
(Adresa)

Prishtinë ***10000***
(Vendi) *(Kodi postar)*

+38344280419
(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Trendelina Qerimi Selmani
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

trendelina.qerimi@novus.consulting
(Adresa elektronike)

NUI: 810818586
NOVUS
sh.p.k.

19.12.2024
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

<u>Më datë 17 shtator 2024</u> – Autoriteti Kontraktues "Agjencioni Veterinarisë dhe Ushqimit " ka Hapur Procesin e Prokurimit Publik me nr. të prokurimit 40800-24-9255-2-1-1, me Titull: "Zhvillimi dhe mirëmbajtja e Sistemit të kontrollimit të ushqimit dhe menaxhimit të gjurmueshmërisë (FCMS)". Më datë 24 Tetor 2024, OE NOVUS SH.P.K , ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim ku AK në po të njejtën datë ka vlerësuar si të pa bazuar. Me datë 29 tetor 2024 OE NOVUS SH.P.K ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin sipas Dosjes së Tenderit për aplikim brenda kohës së paraparë.

<u>Më 29 nëntor 2024</u> – AK ka publikuar Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues. Përmes këtij vendimi, AK ka vlerësuar si të përgjegjshëm OE "TRETEK" SH.P.K., po të njejtën datë OE NOVUS SH.P.K. parashtron kërkesën për qasje në dokumentacionin zyrtar, përgjigjja nga AK është marrë me datë 2 dhjetor 2024, dhe qasja është lejuar më datë 3 dhjetor 2024 në ora 10:00, ku AK ka ngarkuar dosjen ne nje CD.

<u>Më 4 dhjetor 2024</u> – parashtrohet Kërkesa për Rishqyrtim tek Autoriteti Kontraktues Agjencioni Veterinarisë dhe Ushqimit.

<u>Më 10 dhjetor 2024</u> – AK merr Vendim për refuzim si të pabazuar të Kërkesës për Rishqyrtim.

<u>Më datë 19.12.2024</u> - OE NOVUS dorëzon këtë Ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Hapja e tenderëve është bërë ne sistemin e-prokurimi.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po ☒ **Jo** ☐

Nëpërmjet sistemit e-prokurimi.

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK bën shkelje të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, përkatësisht të këtyre dispozitave:

Neni 7 – Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi, *Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.*

Neni 28 – Specifikimet Teknike, *Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit.* ***Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të***

hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

Neni 59, paragrafi 4 - *Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm* ***vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.*** *[...]*

Neni 60, paragrafi 1, pika 1.1. - *1. Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose: 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët; [...]*

Ndërsa sa i përket Rregullores për Prokurim Publik Nr. 001/2022, AK ka bërë shkelje të këtyrë dispozitave:

Neni 17 – Dosja e Tenderit *Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk:* ***a.*** *Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose* ***b.*** *Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE.*
Neni 19- Specifikimet Teknike, *Përcaktimi i specifikimeve teknike që referohen në një prodhim specifik ose burim, ose një proces të veçantë, ose marka tregtare, patenta, lloje ose origjina specifike ose prodhime, është si rregull i përgjithshëm i ndaluar. Megjithatë, një referencë e tillë mund të përdorët në raste të veçanta, nëse referenca e tillë përcjellët me fjalët "ose e barasvlershme/ekuivalente".*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

PËRSHKRIMI I FAKTEVE

Më datë 17 shtator 2024 - AK hap Aktivitetin e Prokurimit Publik me nr. të prokurimit 40800-24-9255-2-1-1, me Titull: "Zhvillimi dhe mirëmbajtja e Sistemit të kontrollimit të ushqimit dhe menaxhimit të gjurmueshmërisë (FCMS)" ("**Aktiviteti i Prokurimit**").

OE Novus edhe më herët ka paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim kundër Dosjes së Tenderit e cila është ndërtuar në kundërshtim me Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, Nr. 05/L-068 dhe Nr. 05/L092 (Ligji Prokurimit ose LPP), dhe Validitetit të certifikatave të punonjësve të Operatorit të rekomanduar për shpërblim me kontratë.

Siç kemi parashtruar edhe në kërkesën e parë për rishqyrtim të datës 24 Tetor 2024, kërkesat teknike të vendosura nga ju si AK lidhur me pozitat e stafit si Analisti i Projektit, Zhvilluesin e Softuerit, Administratorin e Data bazave, BI Specialistin dhe Web Zhvilluesin janë diskriminuese dhe të njëjtat limitojnë ofertat nga OE te interesuara, si dhe të njëjtat nuk janë të nevojshme për të implementuar projektin në fjalë.

Edhe pse nuk janë shqyrtuar dhe aprovuar kërkesat e OE Novus - oferta e dorëzuar nga ana e OE të rekomanduar me kontratë është e papërgjegjshme.
Ndërsa, pretendimet Ankimore të NOVUS lidhur me ofertën e papërgjegjshme të OE Fitues në Kërkesën për Rishqyrtim nuk janë trajtuar fare nga ana e AK, dhe Vendimi lidhur me Kërkesën për rishqyrtim duke marrë përbazë faktet si më poshtë:

1. **Pretendimi ankimor nr. 1: OE i rekomanduar nuk është i përgjegjshëm për shkak se nuk përmbushë kërkesën nr. 1 nga neni 9.1. & 9.2. të Fletës të së Dhënave të Tenderit (FDT)**

Dosja e Tenderit, në nenin 9.1. & 9.2. të FDT-së, ka kërkuar si në vijim:

> "*Operatori ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomikë duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata për shërbime të ngjashme në fushën e zhvillimit të sistemeve dhe aplikacioneve softuerike* ***në 3 vitet e fundit*** *(nënkupton periudhën kohore që paraprinë datën e publikimit te njoftimit për kontrate).* ***Vlera totale e shërbimeve të realizuara duhet të jetë min. 450,000.00 Euro.***"

OE i rekomanduar nuk përmbushë kërkesën nr. 1 të nenit 9.1. & 9.2. të FDT-së, përkatësisht sipas dëshmive të paraqitura për këto kontrata vlera e projekteve që nderlidhen me zhvillimin e aplikacioneve Softuerike nuk e përmbushë vlerën e përcaktuar si kriter për të zgjedhur një operator të përgjegjshëm në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimit per Kontrate per aktivitetin në fjalë.

Fillimisht në dëshmi paraqitet referenca e lëshuar nga kompania "Katrori", por nuk ka dëshmi se kur është realizuar vlera e kontratës me shumë prej EUR 21,240.00, pasi që në listë është paraqitur nga viti 2016 deri me 2022. Ndërsa kriter është që të paraqitet puna e kryer në tre vitet e fundit. Në dëshmi paraqiten edhe kontrata të tjera, të cilat në total nuk arrijnë vlerën totale të shërbimeve të realizuara minimum EUR 450,000.00, të paraqitura si në vijim:

Kontraktuesi i OE të rekomanduar	Vlera e Kontratës
"Katrori"	EUR 21,240.00
"Integra"	EUR 71,200.00
Dogana e Kosovës	EUR 73,839.00
Kontrata të tjera	EUR 22,400.00
Total:	**EUR 188,679.00**

Përveç kësaj, Kontrata e tjera, të cilat kanë vlerë prej EUR 22,400.00 nuk i përkasin shërbimeve të ngjajshme për fushën e zhvillimit të sistemeve dhe aplikacioneve softuerike,

por kanë të bëjnë me zhvillim të uebsiteve, ERP Sistemeve, mirëmbajtje të faturimit mobil, dhe të tjera, të cilat nuk përkojnë më fushën e kërkuar.

Në këtë drejtim OE e rekomanduar me kontratë nuk ka përmbushur as 50% të vlerës së kontratës së shumës së kontratave kërkuara sipas FDT-së duke e bërë të njejtin të papërgjegjshëm.

Në përgjigje të pretendimit ankimor 1, AK konkludon se Komisioni i Vlerësimit "ka verifikuar më shumë se një herë dhe ka arritur në përfundim se kompania ka plotësuar kriterin për Shumën 450,000.00". Mirëpo, nuk ka dhënë asnjë shpjegim se si ka arritur deri në këtë konkludim dhe nuk ka shqyrtuar në thellësi pretendimin e paraqitur të OE NOVUS në bazë të argumenteve dhe fakteve të paraqitura nga ana e këtij të fundit. Kjo përvec nëse AK ka mbajtur të fshehur kontrata të tjera gjatë qasjes në dokumentacion.

2. **Pretendimi ankimor nr. 2: OE i rekomanduar nuk është i përgjegjshëm për shkak se nuk përmbushë kërkesën nr. 3 nga neni 9.1. & 9.2. të Fletës të FDT-së**

Fillimisht, sa i përket kërkesës për një Menxher të Projektit me minimum 7 vite përvojë, i kualifikuar me diplome bachelori, dhe i kualifikuar me certifikate Project Management Professional (PMP), OE i rekomanduar nuk e përmbushë këtë kërkesë të FDT-së.

OE i rekomanduar per kontrate, ne pozitën kyce te Projekt Menaxher ka rekomanduar personin Kushtrim Cernobregu, ne CV-n e dëshmuar nga ai nuk paraqitet se ka pervoje ne Menaxhimin e Projekteve, pozitat e tij nuk janë relevante me kerksen ne dosjen e tenderit dhe njoftimin per kontrate pasi qe janë kryesisht pozita teknike. Gjithashtu, ne kontratën e paraqitur ai eshte i emëruar si Zhvillues i Softuerit per pjese specifike te kontratës per module qe bazohen ne Frame Solutions dhe jo si Projekt Menaxher sic eshte kërkuar. Nder te tjerash eshte kërkuar edhe reference e te paktën 1 projekti te realizuar ne pozitën e Menaxherit te Projektit, ku i njëjti ka ofruar reference nga "Katrori" reference kjo e cila nuk përkon me CV-n e paraqitur si dhe eshte projekt ne vlere minimale dhe nuk mund te krahasohet me rëndësinë dhe fushën e projektit ne fjale.

Këtë pretendim, AK nuk e ka shqyrtuar fare.

Përveç kësaj, sa i përket kërkesës për një Arkitekt softuerik, OE i rekomanduar per kontrate, per kete pozite ka paraqitur Lirim Sylejmanin per te cilin mungon kontrata ose marrëveshja e punës valide me punëdhenesin për këtë projekt pasi që e njejta është kërkuar në dosjen e tenderit si deshmi obligative. Referencat e ofruara si dëshmi nga OE ne fjale, eshte referenca e lëshuar nga Burim Halili, si konsulent Senior ne Projekt "EU supplies support to strengthening capacities of Food Safety, Veterinary and Phytosanitary sectors in Bosnia and Herzegovina", dhe nuk eshte lëshuar nga Autoriteti Kontratues apo organizata te tjera sic eshte kërkuar ne dosje te tenderit dhe ne njoftimin per kontrate, mirëpo nga nje person individual per te cilin nuk dëshmon se eshte pjese e atije projekti si dhe nuk perfaqeson Autoritetin Kontraktues apo Organizatat e tjera siq eshte kerkuar ne dosjen e tenderit si kerkesen obligative.

Për më tepër, OE i rekomanduar per kontrate, per pozite e Analistit të Sistemit, ka paraqitur Besmir Sejdiu per te cilin mungon kontrata ose marrëveshja e punës valide me punëdhenesin për këtë projekt pasi që e njejta është kërkuar në dosjen e tenderit. Gjithashtu, referencat e ofruar si dëshmi nga OE në fjalë , referenca e lëshuar nga OPERA SRL është per pozitën e Non-Key Junior IT Expert, e cila nuk përkon me pozitën e analistit te softuerit ose si zhvilles softueri, si dhe referenca e lëshuar nga Burim Halili, si konsulent Senior ne Projekt "EU supplies support to stregthening capacities of Food Safety, Veterinary and Phytosanitary sectors in Bosnia and Herzegovina", nuk është lëshuar nga AK apo organizata te tjera sic është kërkuar në dosje te tenderit dhe ne njoftimin për kontrate, mirëpo nga një person individual për të cilin nuk dëshmon se eshte pjese e atij projekti si dhe nuk perfaqeson Autoritetin Kontraktues apo Organizatat e tjera siq eshte kerkuar ne dosjen e tenderit si kerkesen obligative.

Sa i përket pozitave të Arkitektit softuerik dhe Analistit të Sistemit, AK në Vendimin për Refuzim ka vlerësuar se për shkak se stafi i ofruar për këto pozita janë njëkohësisht edhe pronarë të OE të rekomanduar, nuk e ka parë të arsyeshme t'i kërkoj kontratat e punës. Një qëndrim i tillë është i papranueshëm pasi që vetëm fakti se një person është aksionar në një kompani nuk do të thotë se i njejti ofron kontribut në punët e kompanisë. Si dhe gjithashtu qeshtja e kerkeses obligative per reference te lëshuar nga Autoriteti Kontratues apo organizata te tjera, si kerkesen obligative e dosjes se tenderit, nuk eshte shqyrtuar fare vetem eshte cekur qe eshte e pranueshme per ne si AUV pa dhene kurfar informacioni shtese.

Për pozitën e dy zhvilluesve senior të softuerit, sa i përket kriterit të vendosur nga ju si AK**,** ku është kerkuar deshmi që së paku njeri nga ta të ketë përvojë me teknologjine Frame Solution, OE i rekomaduar për kontratë ka ofruar si dëshmi një reference nga kompania COMPUTAS me seli në Norvegji e cila nuk eshte e nenshkruar e as e vulosur si deshmi, duke vënë në pikëpyetje vërtetësinë dhe besueshmërinë e saj. Kjo lë hapësirë për dyshime mbi përmbushjen e kërkesës suaj të përcaktuar si kriter në dosjen e tenderit dhe cenon parimet e transparencës dhe barazisë në prokurim.

Kjo mund te vërtetohet edhe nga referenca nga COMPUTAS per Tomor Pupovcin, staf i NOVUS SHPK, e cila eshte e nënshkruar dhe vulosur siq duhet te jete nje reference valide, shih me poshte.

computas

Oslo, Norway, 2024-10-22

To whom it might concern:

Letter of Recommendation

I am pleased to recommend **Mr. Tomor Pupovci**, who served as a Senior Developer with expertise in Software Architecture for the project "Support to Kosovo Veterinary and Food Agency (KVFA) in upgrading and functionalizing information technology systems and increasing its capacity to implement an integrated approach to food safety, EuropeAid/139701/DH/SER/XK."

In this role, Tomor was instrumental in designing and implementing modern, scalable software solutions to enhance KVFA's IT systems. While officially a Senior Developer, he consistently demonstrated the expertise and leadership of a Software Architect, playing a key role in system integration and improving operational efficiency and compliance with EU food safety standards. His technical excellence, problem-solving abilities, and effective collaboration with stakeholders were invaluable to the project's success.

I highly recommend Tomor for any future roles that require a skilled Software Architect or Senior Developer with architectural expertise.

Please feel free to contact me for further information.

Sincerely,

Thomas Bech Pettersen (sign)
CTO, Computas AS

Email: tp@computas.com
Phone: +47 932 48 357

Visiting & Postal Address: Computas AS, Akersgaten 35-39, 0158 Oslo, Norway

Dhe Referenca e ofruar nga OE i rekomanduar për kontrate për Veton Shalën, reference kjo e pa nënshkruar.

computas

To whom it might concern:

Letter of Recommendation

In my role as functionally responsible (key expert) for the Computas-led Case Management Information System (CMIS) project for the courts and prosecution service in Kosovo, represented by the Kosovo Judicial Council (KJC) and Kosovo Prosecutorial Council (KPC), managed by IMG - The International Management Group - I have had the pleasure to have

Veton Shala

on the development team.

The project started in January 2016, delivered the first release which was deployed into practical use in April 2017, and has delivered several functional upgrades for the remainder of the development project until the end of November 2018. From December 2018 the project has been in the maintenance and continued development phase. The development and maintenance projects are both financed by the Royal Norwegian Ministry of Foreign Affairs, through the Norwegian Embassy to Kosovo and Albania in Prishtina, Kosovo.

The work has been on JavaScript (client side) and C# (server side) programming, REST-based communication using JSON-encoded data, SQL Server database, Word document templates and FrameSolutions™ Adaptive Case Management (ACM) platform for declarative work process and task support representations, configurable reference data and the ACM application blueprint.

Veton has proven to be a well-qualified and valuable developer and team member, with a constant eye on correct functionality and good code quality, steadily taking on new challenges for the project.

With regards,

Thomas Bech Pettersen (sign)
CTO, Computas AS

Email: tp@computas.com
Phone: +47 932 48 357

Visiting Address: Computas AS, Akersgaten 35-39, Oslo, Norway

Postal Address: Computas AS, P.O.Box 9031 Grønland, 0133 Oslo, Norway

AK, këto dëshmi, në bazë të Vendimit për Refuzim, i ka konsideruar si valide, edhe pse vërehet qartë se këto dëshmi nuk përmbajnë të gjitha elementet për t'u konsideruar si valide dhe të besueshme.

Së fundmi, OE i rekomanduar për tu shpërblyer me kontratë ka ofruar si dëshmi për certifikatën “MS SQL Server- Database Development dhe Designing Optimizing and Maintaining a Database Administrative Solution for MS SQL Server”, kopjen e përfundimit të kursit specifik nga një partner trajnimi ndërsa nuk ka ofruar certifikatën e nivelit profesional të verifikuar nga Microsoft, pra eshte vetëm trajnimi i përfunduar per kete lloj certifikate, por jo certifikimi i kerkuar nga vet AK ne dosjen e tenderit si dëshmi obligative.

Shih certifikaten e kursit te ofruar si deshmi nga OE i rekomanduar për tu shpërblyer me kontratë:

MICROSOFT CERTIFICATE OF ACHIEVEMENT

This Certificate accredits that

Argëtim Ahmeti

has successfully completed:

Microsoft GOLD CERTIFIED Partner | Learning Solutions

Course 50400: Designing, Optimizing, and Maintaining a Database Administrative Solution for Microsoft SQL Server 2008

an Official Microsoft Learning Product as prescribed by

Microsoft Corporation.

cacttus

Microsoft Certified Trainer

30.11.2010-10.12.2010

cacttus

Part No. 098-102955

Me poshte gjeni formen e certifikates se cila duhet te jete e verifikuar dhe valide sipas kerkese ne dosjen e tenderit qe personi i propozuar te jete i certifikuar:



Microsoft Certificate of Excellence

ANDREAS WOLTER

Has successfully completed the requirements to be recognized as a Microsoft Certified IT Professional, Database Administrator 2008

Bill Gates

William H. Gates
Chairman and Chief Software Architect, Microsoft Corporation

OFFICIAL SEAL OF MICROSOFT CERTIFICATION

Microsoft CERTIFIED IT Professional | Database Administrator 2008

Part No. X13-78064

Prandaj, mbi bazën e të lartcekurave, tenderi i OE të rekomanduar nuk është i përgjegjshëm për shkak se nuk plotëson kërkesën nr. 3 nga neni 9.1. & 9.2. të Fletës të FDT-së.

Në anën tjetër, AK në Vendimin për Refuzim vlerëson se Certifikata e dorëzuar nga OE i shpërblyer me Kontratë është valide sa i përket AUV, edhe pse është dëshmuar nga OE NOVUS se si duket forma e certifikatës e vërtetuar në të vërtetë dhe ajo e dorëzuar nga OE fitues nuk i përmbush kushtet e përcaktuara.

3. **Pretendimi ankimor nr. 3: Duke vendosur specifikacionet e DT, AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 dhe nenin 28 të LPP-së**

Së pari, sipas kërkesës për një "*Analist i Sistemit*", gjatë kërkesës për informata shtesë, OE Novus ka propozuar që, në vend të kualifikimit specifik në .NET, të lejohet dëshmimi i përvojës në sistemet e implementuara të ngjashme. Megjithatë, ky propozim është refuzuar nga Autoriteti Kontraktues (AK).

Në këtë drejtim, OE Novus rithekson se me ***vendosjen e këtij specifikimi është zvogëluar në mënyrë të panevojshme konkurrenca, duke favorizuar operatorë të caktuar ekonomikë, ndërkohë që përvoja dhe aftësitë në sisteme të ngjashme janë më se të mjaftueshme për përmbushjen e nevojave të këtij projekti duke e dëshmuar me referenca direkte nga Autoritetet Kontraktuese ku është realizuar projekti i ngjashëm.***

Përvoja e dëshmuar prej 7 viteve në implementimin e projekteve në fushën e Sigurisë Ushqimore, e kombinuar me edukimin e përshtatshëm, siguron plotësisht kompetencën e kërkuar për këtë rol. Kriteri për kualifikimin në .NET nuk përfaqëson një nevojë thelbësore për realizimin e suksesshëm të projekteve të ngjashme dhe krijon barriera për OE-të që kanë ekspertizë të barasvlershme në sisteme të tjera.

Për dy Zhvillues Senior të Softuerit, OE Novus parashtroi propozime alternative për lehtësimin e kritereve, të cilat u refuzuan nga AK pa arsyetim të qartë, pasi që **Certifikata MS SQL Server - Database Administrator** nuk ofrohet që nga viti 2021. Propozimi që ajo të zëvendësohet me **Azure Developer Associate** ka qenë i bazuar pasi që ajo aktualisht është një certifikatë relevante gjithashtu edhe kërkesa që secili zhvillues të ketë dy certifikime është e panevojshme, pasi certifikatat mund të ndahen mes stafit për të përmbushur kërkesat.

Në lidhje me kërkesën e Administratorit të Databazave, certifikimi i kërkuar nga AK është diskriminues pasi që ky lloj certifikimin nuk ofrohet nga viti 2015 ku automatikisht ky kriter favorizon vetëm individët që kanë pasur mundësinë ta përfundojnë këtë certifikim në të kaluarën dhe nuk reflekton realitetin aktual të tregut të punës dhe teknologjive, duke qenë se ka certifikime më të reja dhe të përshtatura për standardet aktuale.

Pra duke marrë parasysh që OE Novus njeh teknologjinë e zhvillimit te këtij sistemi si dhe detajet thelbësore lidhur me softuerin dhe atëherë ritheksojmë edhe njëherë qe këto kërkesa janë formuluar në mënyrë të tillë që potencialisht favorizojnë një operator të caktuar ekonomik.

Kjo përshtypje mbështetet në këto aspekte:

1. **Specifikimet teknike dhe kriteret e tepruara** që kufizojnë konkurrencën dhe nuk janë të domosdoshme për arritjen e qëllimit të projektit.
2. **Refuzimi i propozimeve alternative të arsyeshme** nga ana e AK-së, të cilat janë në përputhje me kërkesat e projektit, duke rritur kështu barazinë dhe konkurrencën në këtë aktivitet.
3. **Kërkesa për certifikata që nuk ofrohen më nga vitet e kaluara**, të cilat krijojnë një avantazh të panevojshëm për operatorët ekonomikë që tashmë i posedojnë këto certifikata.

AK në Vendimin për Refuzim vlerëson se ky pretendim ankimor i OE NOVUS është i pabazë, me qëndrimin se AK ka respektuar nenin 7 dhe 28 të LPP-së. Mirëpo, vetëm referencimi në nene dhe çka ato përcaktojnë për një AK nuk është arsyetim i mjaftueshëm se AK iu është përmbajtur këtyre dispozitave dhe as përgjigje e duhur në këtë pretendim ankimor.

KËRKESA:

Mbi bazën e argumenteve të mësipërme, ftohet Organi Shqyrtues i Prokurimit që të nxjerr Vendim ashtu që:

I. **APROVOHET** në tërësi si e bazuar Ankesa e OE NOVUS per aktivitetin e prokurimit me nr. të prokurimit 40800-24-9255-2-1-1, me Titull: "Zhvillimi dhe mirëmbajtja e Sistemit të kontrollimit të ushqimit dhe menaxhimit të gjurmueshmërisë (FCMS)" e inicuar nga ana e Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarisë.

II. **ANULOHET** njoftimi për dhënien e kontratës per OE Tretek SHPK me datën 29.11.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me nr. të prokurimit 40800-24-9255-2-1-1, me Titull: "Zhvillimi dhe mirëmbajtja e Sistemit të kontrollimit të ushqimit dhe menaxhimit të gjurmueshmërisë (FCMS)" e inicuar nga ana e Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarisë.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Dëmet materiale do të precizohen në fazat e mëvonshme në qoftë se Organi Shqyrtues i Prokurimit e refuzon ankesën e **NOVUS SH.P.K.**

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për vendimin e Autoritetit kontraktues" dhe njoftimi për anulim te aktivitetit të prokurimit",

b) një kopje e Kërkesës për Rishqyrtim të datës 04.12.2024;
c) një kopje e Vendimit për Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim të datës 10.12.2024;
c) një kopje të Procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*